

VALBONA SINANAJ

**ANALIZA KRAHASUESE MIDIS DY SISTEMEVE FONOLOGJIKE,
ITALISHTES DHE SHQIPES**

Kur dy sisteme fonologjike hyjnë në kontakt, do të ketë në mënyrë të pashmangshme fenomene të interferencës në të gjitha nivelet e gjuhës. Di Giovine thotë se: “gjuhët nuk janë vetëm një tërësi domethëniesh të ndryshme të lidhura me të njëjtën listë konceptesh, por organizojnë në mënyrë të ndryshme paraqitjen konjitive të realitetit”¹.

Kur flitet për gabime të interferencës gjuhësore, zakonisht i referohemi devijimeve në lidhje me një gjuhë model. Shqipfolësi që është duke mësuar italishten L2 kryen gabime, kjo do të thotë që koncepti i gabimeve shënon një distancë midis prodhimit real dhe prodhimit ideal, një objektiv i përealizueshëm fillimisht nga ana e shqipfolësit. Shqipfolësi në hapat e para të mësimi të L2-it bën gabime pasi nuk e njeh italishten, ai është duke e zbuluar dhe e mësuar atë dhe mbi të gjitha interferon gjuha e tij e nënës, pra shqipja L1. Nuk është e lehtë për shqipfolësin të kuptoj fillimisht se si funksionon L2-i, pra për këtë arsye ai bën gabime.

Interferenca fonologjike ndërmjet dy strukturave fonologjike, mund të prodhohet duke pasur parasysh këta faktorë: a) **fonologjikë** (ndryshimet e formave të sistemeve); b) **jofonologjikë** (interferenca ose tentativa e interferencës mund të lidhet me dëshirën për të shmangur homofone të pakëndshme, nga influenca e ortografisë etj.); c) **jashtëgjuhësorë** (me motivime të veçanta, që mund të shtyjnë folësin të gjejë një paraqitje korrekte); d) **rastësorë** (raste jashtë normës).

Fenomenet e interferencës fonologjike shfaqen midis sistemeve fonologjike, të pranishme në folësin shqiptar, pra, sistemi fonologjik amtari i mësuar që fëmijë, dhe më pas atij që mëson në vazhdim. Interferenca fonologjike paraqitet në kontaktin gjuhësor me një gjuhë tjetër, nis, në kompetencën e vetë individit.

Koncepti “interlingua” përdoret për gjuhën e zotëruar në momentin kur nis të mësohet L2-i, në çfarëdo faze të mësimi të jetë praktikanti. Pra, mund të përkufizohet si një gjuhë e papërsosur e zotëruar nga personi, që po tenton të përvetësojë një sistem të ri gjuhësor. Koncepti “interlingua”, është përkufizuar për herë të parë nga Larry **Selinker** në 1972. Paraqitjet gjuhësore të një praktikanti nuk ndërtojnë një grumbull fjalish të mbushura me gabime, por një

¹P. Di Giovine, *Lezione sull'Indoeuropeo ricostruito*, dispensa, dipartimento di Glottologia, Facoltà di Lettere e Filosofia, “La Sapienza” di Roma, 2002.

sistem të udhëhequr nga rregulla të sakta, edhe pse të tilla rregulla, u përgjigjen vetëm një pjese të rregullave të gjuhës pritëse (Lo Duca, 2003: 227).

Gjuha e praktikantit ndryshon shpesh me shpejtësi, dhe është ai skenaristi i riorganizimeve rrënjësore, hap pas hapi që mëson tipare të reja, që do të thotë, tinguj të rinj, morfema të reja, fjalë të reja. Interligua është një sistem dinamik, i përkohshëm dhe i paqëndrueshëm.

Çomski (themelues i gjenerativizmit), propozoi një teori të mësimi gjuhësor, që kundërshtonte në mënyrë rrënjësore teoritë komportamentiste. Sipas komportamentistëve mësimi i gjuhës amtare është rezultat i zakoneve të formuara. “Të mësosh një gjuhë kuptohet si të të bëhet zakon i disa sjelljeve nëpërmjet imitimit të një modeli dhe ripërsëritjes së zgjatur i sekuencave të veprimeve, të cilat duhet të mësoheshin (Pallotti, 1998: 17).

Në këtë vështrim, “mësimi i një gjuhe të dytë (L2), qëndron në formimin e zakoneve të reja, që fitojnë pushtet mbi zakonet e krijuara nga gjuha amtare (L1), (Ciliberti, 1994: 42).

Në ndryshim nga komportamentistët, Çomski nuk beson se fëmija, që po mëson gjuhën e tij, po imiton modele dhe rregulla automatike; por, beson që mbi bazën e të dhënave gjuhësore fëmija është duke zbuluar dhe njohur rregulla. Megjithatë, varfëria e të dhënave që arrijnë në mënyrë rastësore në veshin e fëmijës, bashkë me mungesën e shkallëzimeve dhe vështirësive të larmive dhe modeleve të ekzekutuara për situata të ndryshme, argumentit, kanalit të transmetimit etj., bëjnë që procesi i mësimi nuk mund të imagjinohet si një zbulim i thjeshtë induktiv i rregullave të një gjuhe.

Çomski e interpreton procesin e mësimi të një gjuhe amtare, si fryt i ndërveprimeve të dy përbërësve dallues: nga njëra anë të dhënat gjuhësore parësore, që fëmija ekspozon në periudhën foshnjore, dhe nga ana tjetër, një sistem të parashikimeve të sakta mbi formën dhe organizimin që një sistem gramatikal mund të marrë; një kompleks principesh të organizuara të strukturës gramatikale të gjuhëve natyrale, që nuk është irracionale të mendosh pasurinë gjenetike të qenies njerëzore, fryt edhe ajo, bashkë me aftësitë intelektuale të njeriut, nga evoluimi dhe selektimi natyral i qenies (Cinque, 1991: 228). Ky kompleks principesh organizative, e pajis fëmijën me një seri shumë të kufizuar të hipotezave mbi rregullat gramatikale të gjuhës që është duke mësuar, dhe e vendos në gjendjen të procesojë të dhënat gjuhësore.

Përveç gjuhësisë çomskiane, kontributi i psikologjisë konjitive, ka modifikuar thellësisht mënyrën e konsiderimit të procesit të mësimi të një gjuhe. Ndërsa në kuadrin teorik të komportamentistëve, praktikanti shihet si një *tabula rasa*, gati kompletësisht pasiv dhe në mëshirë të nxitjeve të jashtme, në psikologjinë konjitive shihet si një veprues aktiv. Kërkimet e psikologjisë konjitive, kanë eksploruar fenomene të tilla si, kujtesa, përqendrimi, perceptimi, arsytimi dhe zgjidhja e problemeve kanë ndihmuar në qartësimin e idesë së kreativitetit dhe pavarësisë të praktikantit. Çdo mësim gjuhësor,

edhe ai spontan dhe natyral, bazohet mbi rindërtimin, nga ana e praktikantit e rregullave që udhëheqin sistemin e gjuhës

Studimet e “interlinguës” preferojnë si objekt studimi, praktikantë që mësojnë L2-in në mënyrë natyrale, pa qenë të vendosur në një sistem shkollor, në mënyrë tipike, emigrantët e rritur, të cilët përfshihen për arsye punësimi në një komunitet nazional dhe tentojnë të zotërojnë gjuhën me të cilën u flitet. Emigrantët, të shtyrë nga një presion i fortë komunikativ, të motivuar që të shprehen në gjuhën e re për të mbijetuar dhe punuar, dhe shpesh pa asnjë guidë duhet të vënë në zbatim të dhënat gjuhësore ekskluzivisht me strategjitë e tyre natyrale, duke i reaguar *inputit* sipas mënyrave, që kanë qenë edhe ato objekt studimi (Lo Duca, 2003: 231).

Vërejte fonetike-grafike në analizën krahasuese midis italishtes dhe shqipes

Nga analiza krahasuese e dy sistemeve fonologjike të italishtes dhe të shqipes, vërehet se të dy sistemet kanë disa pika të përbashkëta dhe disa pika kritike jo të rëndësishme.

Duke u ndalur mbi ndryshimet fonetike-grafike midis italishtes dhe shqipes, mund të mënjanohej disa gabime të zakonshme që verifikohen në fazën e parë të mësimin të italishtes. Pikat kritike, përsa i përket anës fonologjike, të cilat krijojnë interferencë (pra, mbivendosjen e strukturave të L1-it shqipes mbi strukturat L2-it të italishtes që janë duke u fituar), përcaktohen nga zakonet fonetike-nyjëtimore të marra në L1.

Shkronja c e shqipes lexohet si z -ja <i>testanza</i> (z e shurdhët)
Shkronja g e shqipes lexohet si g -ja <i>tegallo</i> (g velare)
Shkronja h e shqipes është e frymetuar lexohet si h -ja te <i>hanno</i>
Shkronja j e shqipes lexohet si i -ja <i>teferi</i> (gjysëmzanore)
Shkronja k e shqipes lexohet si c -ja <i>te casa</i> (velare)
Shkronja ll e shqipes lexohet si ne angl. <i>bottle</i>
Shkronja nj e shqipes lexohet si grupi gn te <i>agnello</i> (palatale)
Shkronja q e shqipes lexohet “ chi ” (dialektikisht ndonjëherë <i>ci</i>)
Shkronja r e shqipes lexohet si një r mjaft e shkurtër angl. <i>right</i>
Shkronja rr e shqipes lexohet si rr -ja te <i>carro</i>
Shkronja s e shqipes lexohet si s -ja <i>tesuono</i> (e shurdhët)
Shkronja sh e shqipes lexohet si grupi sc <i>tescivolo</i>
Shkronja x e shqipes lexohet si z -ja <i>tezuppa</i> (e zëshme)
Shkronja xh e shqipes lexohet si g -ja <i>te giallo</i> (palatale)
Shkronja z e shqipes lexohet si s -ja <i>te rosa</i> (e zëshme)

Një ndryshim që prodhohet në nivelin fonetik grafik, ka lidhje me /z/-në: në italisht sibilantja e zëshme shënohet grafikisht me <s> (nuk dallohet nga e shurdhëta), dhe mund të gjendet në vend të saj vetëm para një tjetër

bashkëtingëllore të zëshme, p.sh. ital. *sdentato*, bashkëtingëllore të zëshme, p.sh. shq. *s'dua-z'dua*, *asgjë-azgjë*, ose dhe në pozicion ndërzanor, p.sh. ital. *rosa/rōza* gjithmonë të lehtë. Meqë, pozicioni i vetëm ku janë të mundura çiftet minimale midis /s/-së dhe /z/-së është pozicioni ndërzanor (Muljačić, 1972: 45) dhe kjo mundësi nuk përdoret gjerësisht në zonat e Italisë Veriore (ku ka gjithmonë [-z-]) dhe në Jug (ka gjithmonë [-s-]), vendimi i vlerësimit apo i jovlerësimit të /s/-së dhe /z/-ë si dy fonema të dallueshme është objekt diskutimi².

Si në rastin e mësipërm (vlen edhe për /ts/ dhe /dz/), në shqip në nivelin fonologjik grafik /s/ dhe /z/ janë dy fonema të dallueshme, që do të thotë formojnë çifte minimale me vlerë rëndësore, p.sh. *si* (ndajfolje pyetëse) ~ *zi* “lutto” (edhe *i zi* “nero”: në ligjërim, shqipfolësit natyrisht e kapin ndryshimin italian, por në shkrim jo gjithmonë janë të kujdesshëm, meqenëse ndryshimi është pikërisht grafik. Nga ana fonologjike ajo që krijon interference, (mbivendosje të strukturave të shqipes L1 në përvetësimin e italishtes) janë të caktuara nga shprehitë fonetike – artikulatore të përvetësuara në L1.

Ajo që vërehet në formimin fonologjik të /r/ alveolare të italishtes është shqiptimi si monovibrante (Canepari 1972: 97), ang. *right* dhe shpesh retroflekse, ndërsa në shqip vibrantia /r/ është lehtësisht retroflekse. Në shqip kemi edhe polivibranten /rr/ me 3-4 dridhje *rrota*, *it.ruota*. Ky fenomen që manifestohet në shqip, përbën një problem për folësin shqiptar kur do të flasë italisht, sepse fonemat në italisht janë të dallueshme vetëm për të treguar shkallën e artikulimit p.sh. *caro* – *carro*, në këtë rast shkalla e intensitetit është funksionale dhe në italisht /r/ e /rr/ kundërvihen për forcën, gjatësinë, ndryshe nga shqipja. Një shqiptar që është duke mësuar italishten e ka të vështirë të shqiptojë /r/ e italishtes, sepse ky tingull në inventarin fonologjik të shqipes u përgjigjet dy fonemave të ndryshme /r/ dhe /rr/, megjithëse formohen në të njëjtin vend artikulimi, pra *deri* – *derri*, *var* – *varr*.

Në shqip nuk janë karakteristike bashkëtingëlloret dyshe, pra nuk ka *geminate*, kjo do të thotë që *intenset* e italishtes si *scempiano* përshtatshmërisht në shqip. Shkalla e shqiptimit është relevante kur një energji e ndryshme artikulatore bën dallimin për një folës italian të ndryshimit ndërmjet çifteve divergjente: *fato* – *fatto*, *pala* – *palla*. Ky

² Krahavar, D'Achille: “l'opposizione fonologica sussiste solo in Toscana, dove si individuano alcune coppie minime, come *fuso* /'fuso/ (arnese per filare) e *fuso* /'fuzo/ (participio passato di *fondere*), poche ma sufficienti per considerare /z/ un fonema distinto da /s/”. ediz., *Breve grammatica storica dell'italiano*, Carocci, Roma 2003, f. 33.

diferencim, fonetiki konsiston jo në ridublimin e fonemës laterale o dentale të shurdhët por në një forcë artikulimi të ndryshëm, kjo p.sh. për një albanofon krijon një problem sepse nuk ka në gjuhën e tij një diferencë ndërmjet *inteseve* dhe *scempieve* apo një dyfishim grafik. Në shqip dyfishimi grafik ekziston vetëm për **ll**-në e **rr**-në, të cilat janë dy fonema të ndryshme dhe me një vlerë fonologjike jo të rimbartshme ndërmjet *intenseve* dhe *scempieve*.

Në gjuhën e shkruar shqip nuk përdoret theksi, pra fjalët shkruhen si shqiptohen, kjo krijon një vështirësi për një shqipfolës që në fazat e para të mësimin të italishtes i shqipton fjalët në mënyrë të gabuar, pasi gjuha italiane gjatë shkrimit përdor theksin.

Këto përfundime na bindin se për të mësuar apo gjatë përdorimit të një gjuhe të huaj, për interferimin e ndërsjelltë të tyre, është e nevojshme përvetësimi i tingujve duke i vendosur saktë në sistemet fonematike të secilës gjuhe. Çdo gjuhë ka tingujt e vet, edhe ata që duken si identikë janë gjithmonë të përafërt, dhe për të mësuar një gjuhë të huaj duhet të dimë një sistem të rifonematik.

BIBLIOGRAFI

- L. Canepari, *Manuale di pronuncia italiana*, Zanichelli, Bologna, 1972.
A. Ciliberti, *Manuale di glotodidattica*, La nuova Italia, Firenze 1994.
G. Cinque, *Linguistica e glotodidattica*, in Porcelli, Balboni, 1991.
P. Di Giovine, *Lezione sull'indoeuropeo ricostruito*, dispensa, Dipartimento di Glottologia, Facoltà di Lettere e Filosofia, "La Sapienza" Romë, 2002.
C. Chomsky, *Per una teoria della grammatica centrale*, Rivista di grammatica generativa, 1978.
M.G. Lo Duca, *Lingua italiana ed educazione linguistica*, Carocci, Roma, 2003.
I. Mennen, *Phonological and phonetic influences in non-native intonation*. In J. Trouvain and U. Gut, *Non-native Prosody; Phonetic Descriptions and Teaching Practice*, The Hague: Mouton De Gruyter, 2007.
Ž. Muljačić, *Fonologia della lingua italiana*, 1972.

**GJUHA DHE LETËRSIA,
PËRKTHIMTARIA**

